



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 195 / Prot.
37

Tiranë, më 15/05 /2020

URDHËR

Nr. 10, datë 15.05.2020

“PËR NJË SAKTËSIM NË URDHËRIN NR. 38, DATË 08.05.2020”

Në bazë të nenit 131 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, Urdhërve të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritete...”, i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 108, datë 08.05.2020 “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid-19”, nenit 5 e vijues të Rregullores së Zgjedhjeve në UMT, miratuar nga Senati Akadmik me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”,

URDHËROJ:

1. Titulli i Urdhrit nr.38, datë 08.05.2020 saktësohet si më poshtë:
“Për marrjen e masave paraprake/përgatitore për përgatitjen e zgjedhjeve për autoritete dhe organe drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”
2. Pika 1 e Urdhrit nr.38, datë 08.05.2020, saktësohet si më poshtë:
“1. Marrjen e masave paraprake/përgatitore për zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

REKTORI
ARBEN GJATA

